

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Raporti janar-mars 2023 i DSHMS

Këtë vit e filluam me hapjen e Qendrës së Down Syndrome Kosova në Komunën tonë. Kjo qendër tash e tre muaj ofron shërbime profesionale për fëmijët me Down Syndrome.

Komisioni për barëra dhe pajisje të tjera mjekësore

Janar- kanë aplikuar 134 persona, kanë përfituar 96, shuma totale 9 mijë 910 euro.

Shkurt- kanë aplikuar 140 persona, kanë përfituar 111, shuma totale 11 mijë 080 euro.

Mars- kanë aplikuar 136 persona, kanë përfituar 93, shuma totale 9 mijë 900 euro

Komisioni për banim social

Gjithsej kanë aplikuar 59 familje, 55 kërkesa janë aprovuar ndërsa 4 janë refuzuar. Shuma për pagesë 4690 euro për muaj, e vazhdon tutje me po të njëjtën shumë, për çdo muaj deri në përfundim të vitit.

Gjithashtu janë ndihmuar dy familje strehuese dhe një adoptuese me nga 750 euro, në total 2250 euro.

Aktualisht përfitues të asistencës sociale i kemi 573 familje. Që të gjitha këto familje, por dhe kategori të tjera në nevojë të shoqërisë kanë përfituar nga shpërndarja e afërsisht 950 pakove ushqimore, të dhuruara nga organizata të ndryshme bamirësie e individë.

Kemi përfunduar kontrollet sistematike për nxënësit e klasave I, V, IX. Në total 24 shkolla e 3053 nxënës.

Nga muaji shkurt, rikthyem kontrollet mjekësore për pensionistët në qendrën e pensionistëve, një herë në javë mjeku qëndron në qendër.

Shërbimet shëndetësore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare, kanë marrë 47 mijë e 647 pacientë.

3839- Shërbime stomatologjike

9971- Shërbime laboratorike

764- marrës të shërbimeve të kujdesit paliativ

348- Të vaksinuar nga mosha 0-18 vjet

173- Vizita shtëpiake, nga programi për nëna dhe fëmijë 0-3 vjet

12263- Insulina të shpërndara nga barnatorja qendrore

1119- Pacientë të furnizuar me barëra